

# SBASHK Arsimimi sot

Prill, 2025

Gazeta elektronike

## SBASHK-u vazhdoi me gjithpërfshirje të anëtarëve nëpër trajnime



SBASHK-u, gjatë muajit prill, ka organizuar fillimin e 16 grupeve të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” si dhe në atë “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, në disa komuna të ndryshme të Kosovës... (faqe 4)

## SBASHK-u filloi përgatitjet për pushime në bregdetin shqiptar për anëtarët e vet.



SBASHK-u, gjatë muajit prill, ka vazhduar me përgatitjet për pushimin e anëtarëve në bregdetin shqiptar. Gjatë një takimi me kryetarët e... (faqe 7)

## Intervistë me kryetarin e FSASH-it, Shpetim Brahaj



Në fund të muajit që shkoi, SBASHK-u kishte mirëpritur një delegacion të Federatës të Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH), të kryesuar nga kryetari Shpetim Brahaj ... (faqe 3)

## Vonesa e themelimit të institucioneve po cenon të drejtat e mësimdhënësve



Mësimdhënësit e Kosovës tash e disa vite janë duke kërkuar të drejtat e tyre sindikale... (faqe 2)

## SBASHK-u u prit nga drejtoresha e Arsimit në Komunën e Obiliqit



Udhëheqësit e SBASHK-ut, nënkryetarja Vjollca Shala dhe Sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, së bashku me kryetaren e SKAP-it për Obiliq, Luljeta ... (faqe 8)

## Editorial

### Vonesa e themelimit të institucioneve po cenon të drejtat e mësimdhënësve

Mësimdhënësit e Kosovës tash e disa vite janë duke kërkuar të drejtat e tyre sindikale, të cilat kanë hasur në vesh të shurdhër të institucioneve përgjegjëse: Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Financave, Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës.

Vonesa e krijimit të institucioneve të reja, të dala nga zgjedhjet e 9 shkurtit 2025, po godet drejtpërdrejt të drejtat sindikale të mësimdhënësve në Kosovë. Kjo vonesë po bën që të kemi ende në detyrë një ministri dhe qeveri që në vazhdimësi ka injoruar kërkesat e anëtarësisë së Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës.

Këto të drejta përfshijnë nënshkrimin e një Kontrate të re Kolektive, Ligjin për Pagat, rritjen e vlerës së koeficientit të pagave si dhe Projektligjin për Skemat Pensionale.

Dhjetëra mijëra mësimdhënës të përfaqësuar nga SBASHK-u, tash e tri vite, në mungesë të Këshillit Ekonomik Social, nuk kanë një adresë kudo t'i përfaqësojnë interesat e tyre. Si rrjedhojë e mosformimit të këtij Këshilli nga ana e Qeverisë, vendimet për përfaqësimin e mësimdhënësve dhe punonjësve të tjerë në Kosovë, i merr Ministri i Financave në mënyrë të njëanshme, pa i konsultuar përfaqësuesit e punëtorëve, gjë që ka ndikuar në cilësinë dhe njëanshmërinë e këtyre vendimeve në favor të punëdhënësit, e jo të punëtorëve.

Mësimdhënësit tashmë po hyjnë në vitin e dytë pa një Kontratë Kolektive të nënshkruar me MASHTI-n, meqë kjo e fundit e ka injoruar Draftin e Kontratës të dorëzuar nga SBASHK-u për negociim, me

arsyetimin se Ministrja e MASHTI-it e kishte shkëputur Kontratën në mënyrë të njëanshme në nëntor të vitit 2022.

Kjo Kontratë Kolektive iu mundëson mësimdhënësve mbulimin e shpenzimeve për udhëtim, kompensimin e shujtës dhe shpërblimin jubilar, si të drejta bazike të punës.

Ndërkohë, në shtator të vitit 2024, SBASHK-u kishte dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës një Peticion me mbi 20 mijë nënshkrime, duke kërkuar nga deputetët plotësim-ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale. Me këtë ligj, mësimdhënësve do t'u njihej kontributi i punës gjatë viteve '90, kur mësimi mbahej nëpër shkolla-shtëpi, për shkak të dëbimit nga institucionet arsimore nga regjimi okupues serb.

Megjithatë, të gjitha këto padrejtësi që po u bëhen mësimdhënësve tash e katër vite, nuk po mund të gjejnë zgjidhje për shkak të mungesës së institucioneve shtetërore në vend dhe moskonstituimit të Kuvendit të Kosovës të dalë nga zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, i cili do t'i hapte rrugë formimit të qeverisë dhe adresimit të kërkesave të mësimdhënësve në rrugë institucionale.

Andaj, duke e pasur parasysh këtë "ngërç" të të drejtave të mësimdhënësve, të cilat ua garanton edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, SBASHK-u kërkon konstituimin sa më të shpejtë të Kuvendit dhe formimin e institucioneve të dala nga zgjedhjet e 9 shkurtit, në mënyrë që t'i hapet rrugë adresimit dhe dialogimit të kërkesave të mësimdhënësve të përfaqësuar nga SBASHK-u.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spotet në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel: +383 (0) 38 226 940





## Intervista

### Intervistë me kryetarin e FSASH-it, Shpetim Brahaj



Në fund të muajit që shkoi, SBASHK-u mirëpriti një delegacion të Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH), të kryesuar nga kryetari Shpetim Brahaj. Pjesë e delegacionit ishin edhe nënkryetarja Blerina Qemali, sekretari organizativ Bashkim Shyle dhe anëtarja e Këshillit Drejtues, Brikela Zeqollari.

Lidhur me këtë vizitë dhe bashkëpunimin ndërmjet SBASHK-ut dhe FSASH-it, zhvilluam një intervistë me kryetarin e FSASH-it, Shpetim Brahaj, i cili ndër të tjera tha se ky është një hap i rëndësishëm në ndërtimin e marrëdhënieve mes dy sindikatave.

**SBASHK:** Muajin e kaluar vizituat SBASHK-un. Sa e rëndësishme ishte kjo vizitë për ju dhe për FSASH-in?

**Brahaj:** Vizita në SBASHK ishte shumë e rëndësishme për FSASH-in, sepse forcoi më tej lidhjet e qëndrueshme të bashkëpunimit mes sindikatave tona. Ajo ishte një hap kyç për konsolidimin e marrëdhënieve dhe për të theksuar nevojën që FSASH-i dhe SBASHK-u të bashkëpunojnë ngushtë edhe në arenën ndërkombëtare, duke folur me një zë të përbashkët në forumet sindikale evropiane dhe botërore, si ETUC dhe të tjera, për të bërë më të dëgjuar zërin e mësuesve shqiptarë.

**SBASHK:** Si është bashkëpunimi juaj me SBASHK-un? Sa i rëndësishëm është ai dhe si e përjetuat vizitën në Kosovë?

**Brahaj:** Bashkëpunimi me SBASHK-un është tradicional, i ngushtë dhe shumë i rëndësishëm për të dy sindikatat. Nëpërmjet tij, arrijmë të mbështesim më fort njëri-tjetrin dhe të forcojmë rolin tonë në mbrojtje të të drejtave të punonjësve të arsimit. Vizita në Kosovë ishte e ngrohtë, e mbushur me miqësi dhe respekt të ndërsjellë, duke forcuar ndjesinë e solidaritetit ndërmjet nesh.

**SBASHK:** Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballet FSASH-i në Shqipëri dhe sa ngjashmëri kanë me sfidat e SBASHK-ut në Kosovë?

**Brahaj:** Sfida kryesore për FSASH-in në Shqipëri mbetet financimi i pamjaftueshëm i arsimit, kushtet e punës për mësuesit, garantimi i të drejtave sindikale dhe rritja e anëtarësisë. Këto sfida janë shumë të ngjashme me ato të SBASHK-ut në Kosovë, i cili gjithashtu përballet me mungesë financimi të mjaftueshëm, mosrespektim të kontratave kolektive dhe presione të vazhdueshme ndaj mësuesve. Prandaj, shkëmbimi i përvojave dhe bashkëpunimi i ngushtë mes nesh është domosdoshmëri.

**SBASHK:** Në cilat fusha mendoni se duhet të thellohet më tej bashkëpunimi ndërsindikal mes Kosovës dhe Shqipërisë?

**Brahaj:** Bashkëpunimi ndërsindikal duhet të thellohet në:

- Harmonizimin e politikave për mbrojtjen e të drejtave të punonjësve të arsimit;
- Forcimin e kapaciteteve organizative dhe lobuese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Shkëmbimin e praktikave më të mira në menaxhimin e dialogut social dhe negociatave kolektive;
- Nxitjen e projekteve të përbashkëta për zhvillimin profesional të mësuesve;
- Mbrojtjen e lirisë sindikale dhe adresimin e sfidave të përbashkëta sociale dhe ekonomike.

Ky bashkëpunim do të fuqizojë më tej rolin e sindikatave tona përballë sfidave të globalizimit dhe integritit evropian.

**SBASHK:** Gjatë kësaj vizite në Kosovë, nënshkruat edhe një marrëveshje bashkëpunimi me SBASHK-un. Si u prit kjo marrëveshje nga anëtarësia dhe kolegët tuaj sindikalistë në Shqipëri?

**Brahaj:** Marrëveshja është pritur me entuziazëm dhe mbështetje të gjerë. Është vlerësuar si një hap strategjik për forcimin e unitetit sindikal mbarëkombëtar, për rritjen e kapaciteteve për mbrojtjen e të drejtave të punonjësve të arsimit dhe për zgjerimin e platformave të bashkëpunimit në çështje me interes të përbashkët. Ky akt ka krijuar një ndjesi të re optimizmi dhe angazhimi për realizimin e objektivave të përbashkëta, duke reflektuar vetëdije të lartë për rëndësinë e solidaritetit sindikal në proceset shoqërore dhe arsimore.

## TRAJNIMET

### SBASHK-u vazhdoi me gjithpërfshirje të anëtarëve nëpër trajnime



Në Shtime, testi u administrua nga Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, kurse i pranishëm për ta përcjellë nga afër testin ishte edhe kryetari i SKAP-it për Shtime, Xhavit Rexhaj. Këtë grup të trajnimit e kishte udhëhequr trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Ferid Shaqiri.



Në Suharekë, Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi, organizuan edhe dy grupe të testimit, ku trajnerë të përcaktuar nga SBASHK-u ishin Emin Hoxha dhe Skënder Gashi. Kurse për ta përcjellë nga afër testin ishte edhe kryetari i SKAP-it për Suharekë, Nazim Gashi.



SBASHK-u, gjatë muajit prill, ka organizuar fillimin e 16 grupeve të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” si dhe në atë “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, në disa komuna të ndryshme të Kosovës.

Gjatë po këtij muaji, SBASHK-u organizoi edhe administrimin e testeve për 13 grupe të tjera që e kishin filluar më herët këtë trajnim dhe që e përfunduan në prill.

Në fundjavën e fundit të prillit, SBASHK-u administroi testet për shtatë grupe të mësimdhënësve, të cilët e kishin përfunduar trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.

Të dielën, SBASHK-u organizoi tri grupe të testimit për mësimdhënësit që kanë ndjekur trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, në Shtime dhe Suharekë.





Të shtunën Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri së bashku me zyrtarin ligjor, Blendor Shatri organizuan testin për një grup të mësimit në Gjilan, ku trajner ishte Xhemail Kastrati dhe një grup me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK, Musli Neziri.




Kurse në Viti, Sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri dhe zyrtari ligjor Shatri, organizuan testin për një grup të mësimit në Viti të cilët e kishin përfunduar modulin dy të trajnimit “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimit”, me trajnerin e përzgjedhur nga SBASHK, Musli Neziri. Ndërkohë, në po të njëjtën ditë, Nënkyetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe zyrtarja Afërdita Ahmeti, organizuan testin për grupin e dytë të mësimit në cilin ishte udhëhequr nga trajneri Xhemail Kastrati, po në Gjilan.






# Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Teste për mësimdhënës të cilët e kanë përfunduar këtë trajnim ishin mbajtur një javë më parë edhe në Ferizaj, ku dy grupe të testimit ishin administruar nga Nënkyetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe Sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, derisa trajnimet ishin udhëhequr nga trajnerët: Arsim Qalaj dhe Xhemil Halili. Gjatë testimit në Ferizaj, mësimdhënësit u vizituan edhe nga kryetari i SKAP-it për këtë komunë, z. Fejzullah Vranovci.



Teste për dy grupe të mësimdhënësve të cilët e filluan më parë trajnimin, gjatë muajit prill, u mbajtën edhe në Klinë, ku dy grupe të mësimdhënësve u certifikuan në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”. Testet në Klinë u administruan nga Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtari ligjor, Blendor Shatri, kurse grupet e trajnimit janë udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Fejzullah Berisha.



Ndërkohë, po gjatë vikendit të 19 dhe 20 prillit, SBASHK-u filloi edhe me 14 grupe të reja të trajnimit në programet “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”.

Në Kaçanik, gjatë muajit prill, SBASHK ka filluar me 3 grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, ku trajnimet po i udhëheqin trajnerët e përcaktuar nga SBASHK, Naser Guri dhe Avni Krasniqi.



Gjatë po këtij muaji, edhe në Pejë filluan dy grupe të trajnimit: një në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajner Burim Krasniqi dhe një grup trajnimi në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajner Ilir Gashi.

Dy grupe të trajnimit kishin filluar edhe në Mitrovicë: një në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajner Fejzullah Berisha dhe një grup në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajner Lindita Muja.

Kurse në Podujevë, gjatë prillit kishin filluar dy grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajner Kadri Hyseni.







Kurse me dy grupe të trajnimit kishte filluar edhe Malisheva, gjatë muajit prill, ku në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” kishte filluar një grup trajnimi nën udhëheqjen e trajnerit Albert Samadraxha, dhe një grup në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” me udhëheqjen e trajnerit Arben Krasniq.



Gjatë këtij muaji kishte filluar edhe një grup trajnimi në Fushë-Kosovë, në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK, Arben Zymeri.



Kurse në Viti ishte mbajtur një grup trajnimi në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajner Makfirete Zuka.




Ndërsa një grup trajnimi në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajner Gani Kryeziu, gjatë prillit ishte mbajtur edhe në Rahovec.



Ndërkohë, në Gjilan e Viti kishin filluar tri grupe të reja të trajnimit në fillim të këtij muaji, në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, ku dy grupe të mësimdhënësve në Gjilan ishin udhëhequr nga trajnerja Ibadete Limani dhe një grup i mësimdhënësve në Viti, nga trajneri Musli Neziri.

## SBASHK-u filloi përgatitjet për pushime në bregdetin shqiptar për anëtarët e vet



SBASHK-u, gjatë muajit prill, ka vazhduar me përgatitjet për pushimin e anëtarëve në bregdetin shqiptar. Gjatë një takimi me kryetarët e Sindikatave Komunale të Arsimit Parauniversitar (SKAP), është diskutuar edhe për ecurinë e trajnimeve për mësimdhënësit dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve nëpër Shoqata Sindikale.

Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i përgëzoi udhëheqësit e niveleve komunale të sindikatës për punën e shkëlqyer në shërbim të anëtarësisë në të gjitha drejtimet.

Jasharaj tha se punët rreth përgatitjeve për pushimin e mësimdhënësve

në bregdetin shqiptar, trajnimet të cilat SBASHK-u i organizon për anëtarësinë, si dhe zgjedhjet sindikale po ecin mirë, andaj kërkoi që të vazhdohet ky ritëm i punës e përkushtimit, në mënyrë që shërbimet për anëtarësinë të jenë sa më cilësore.

Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, tha se trajnimet për mësimdhënësit anëtar të sindikatës po vazhdojnë me një dinamikë të lartë, ku aktualisht janë duke u zhvilluar mbi 20 grupe të trajnimit njëkohësisht në të gjitha komunat e Kosovës.

Kurse Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, kërkoi nga udhëheqësit komunal të sindikatës që t'i respektojnë me përpikëri rregullat për dërgimin e pushuesve në bregdetin shqiptar, ku të gjithë pushuesit zgjedhen bazuar në kriteret e përcaktuara nga SBASHK-u. Në takimin online me kryetarët, SBASHK-u e diskutoi

edhe ecurinë e zgjedhjeve sindikale të cilat kanë filluar me shoqata sindikale për të vazhduar më pas me komuna dhe deri në zgjedhjen e kryetarit dhe Kryesisë.

Gjatë prillit, lidhur me fillimin e përgatitjeve për pushimin e mësimdhënësve në bregdet, SBASHK-u kishte mbajtur edhe një takim me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve.

Në këtë takim, me shumicë votash, SBASHK-u i kishte aprovuar kriteret për përzgjedhjen e pushuesve për këtë vit ku pritet të jetë mbi 400 pushues, derisa ishte vendos që listat të definohen më së largu deri më 31 maj 2025.

SBASHK-u tradicionalisht organizon pushime 5 ditore për mësimdhënësit anëtar të Sindikatës, ku në mënyrë të organizuar SBASHK-u e dërgon një numër të caktuar të mësimdhënësve për pushim në formë të organizuar, në shenjë simbolike për punën në sektorin e arsimit.

## SBASHK-u u prit nga drejtoresha e Arsimit në Komunën e Obiliqit,

Udhëheqësit e SBASHK-ut, nënkryetarja Vjollca Shala dhe Sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, së bashku me kryetaren e SKAP-it për Obiliq, Luljeta Boshnjaku, janë takuar me drejtoreshën e Drejtorisë Komunale të Arsimit, Fitore Hashani dhe shefin për Arsim, Rexhep Zeka, në një takim njoftues.

Në këtë takim, përfaqësuesit e SBASHK-ut u pritën ngrohtësisht nga drejtoresha e DKA-së, Fitore Hashani,

ku u diskutua për mbështetjen institucionale për çështjet që ndërlidhen me arsim, siç është Kontrata Kolektive, organizimi i trajnimeve për mësimdhënësit e kësaj komune dhe bashkëpunimi sindikal me DKA-në.

Drejtoresha e DKA-së, Fitore Hashani, në emër të Kryetarit të Komunës dhe DKA-së, shprehu përkushtimin për bashkëpunim të vazhdueshëm dhe ofroi mbështetje për të drejtat e stafit arsimor në përgjithësi.





## Përfaqësues të SBASHK-ut morën pjesë në aktivitetin “Dyert e Hapura” të shkollës së “Ymer Prizrenit” në Prizren, ndanë edhe mirënjohje për drejtoreshën Myvedete Gavazaj



Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, morën pjesë në aktivitetin “Dyert e Hapura” të shkollës “Ymer Prizreni” në Prizren, ku ishte ekspozuar një ekspozitë e nxënësve të kësaj shkolle.

Nënkryetarja Shala dhe sekretari Ymeri, u pritën nga drejtoresha e shkollës, Myvedete Gavazaj, të cilën edhe e nderuan me mirënjohje për bashkëpunimin e saj dhe ofrimin e hapësirave të shkollës për mbajtjen e trajnimeve për mësimdhënësit e sindikatës.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut u pritën edhe nga kryetari i SKAP-it në këtë komunë, Reshit Kushaj si dhe panë nga afër punën e sindikatës që po bëhet në shërbim të mësimdhënësve në këtë komunë.



Shkolla “Ymer Prizreni” organizon tradicionalisht aktivitetin e “Dyerve të Hapura” ku hap dyert për prindër, nxënës të ardhshëm dhe komunitetin gjatë këtij aktiviteti.